

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5485  
E premte, 25 maj 2018  
çmimi 0.40 €

## Misioni i EULEX-it përfundon këtë vit

FAQE 3

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX, do ta përfundojë mandatin në fund të këtij viti.

Kështu është bërë me dije të enjten pas takimit që ka zhvilluar presidenti Hashim Thaçi me shefen e misionit të EULEX-it, Alexandra Papadopoulou



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**KRYEPARLAMENTARI VESELI  
SOT VIZITON SHQIPËRINË** F. 2

**KËRKOHEZ ZBATIM MË  
EFIKAS I STRATEGJISË  
SHTETËRORE PËR  
RIINTEGRIM** F. 6

**SHPALLEN FAJTORË TË  
AKUZUARIT NË RASTIN  
'MEDICUS'** F. 6

### EKONOMI

**IMPORTI I MALLRAVE NË  
KOSOVË ARRIN VLERËN MBI  
270 MILIONË EURO** F. 9

**REFORMAT E MINISTRIT  
REÇICA PËRKRAHEN NGA  
BANKA BOTËRORE** F. 8

### KULTURË

**TROKITJE NË PORTËN E  
PARAJSESË** F. 13

BOB DYLAN

**DITË TË KIAMETIT  
NUK KA** F. 13

LULZIM TAFI

### SPORT

**FERIZAJ NË SUPERLIGË** F. 18

**FADIL VOKRRI DHE DUA LIPA,  
NË FINALEN LIVERPOOL - REAL**

F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI | FAQE 4-5

## Asociacioni për fazën finale të dialogut paraqet rrezik

- Presidenti Hashim Thaçi duhet ta udhëheqë fazën përfundimtare të dialogut

Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se lënia e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe për fazën finale të dialogut ndërmjet dy shteteve paraqet rrezik për Kosovën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", ajo ka treguar se në këtë fazë Serbia mund të kërkojë kompetenca shtesë për Asociacionin. Tahiri i ka ftuar subjektet politike për konsensus nacional rreth kësaj çështje. Ish-ministria për Dialog ka treguar pse këtë fazë të dialogut

duhet ta udhëheqë presidenti Hashim Thaçin dhe për këtë pikë u ka bërë thirrje partive për konsensus. Sipas Tahirit, kjo duhet të ndodhë për arsye kushtetuese dhe për shkak të përvojës së madhe në negociata që ka presidenti Thaçi

## Krizat institucionale, pasojë e ambicieve të partive për ta mbajtur pushtetin

FAQE 3

Për dhjetë vjet shtet në Kosovë asnjëra prej qeverive nuk ka arritur ta përfundojë mandatin e plotë qeverisës, kurse krizat institucionale kanë ardhur si pasojë e partive politike për ta ruajtur pushtetin. Kështu është thënë të enjten nga të pranishmit në tryezën e organizuar nga Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D), ku është publikuar punimi me temë "Demokracia e Kosovës në rrezik? Paqëndrueshmëria e sistemit partiak, kohëzgjatja e Qeverisë dhe kriza institucionale në Kosovë"



## QKUK-ja bëhet me repart të ri të shërbimit intensiv

Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) të enjten është përfunduar Shërbimi i ri Intensiv, i cili është pajisur me 27 shtretër dhe tani ka kapacitet për 1 000 pacientë gjatë vitit | FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Pritren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERLABIANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Sessions: Të forcohet partneriteti me vendet e Ballkanit

ZAGREB, 24 MAJ - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë ta forcojnë partneritetin me vendet e Ballkanit në luftën kundër ekstremizmit dhe krim-it të organizuar, ka thënë

prokurori i Departamentit të Shtetit të ShBA-së, Jeff Sessions. Në një takim zyrtarë të zbatimit të ligjit nga Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia

në Zagreb, ai tha se bashkëpunimi ka treguar tashmë rezultate të mira, por që mund të bëhet edhe më shumë. "Ne përballemi me një kërcënim serioz nga terrorizmi,

kontrabanda e drogës dhe njerëzve, krimi i organizuar dhe korrupsioni. Kriminelët e zgjuar përdorin kufij për t'u fshehur pas tyre. Nuk duhet ta lejojmë këtë", ka thënë Jeff Sessionsi.



# Hapja e negociatave në qershor, qasja më e mirë strategjike për vendin

Presidenti Meta, gjatë takimit me zyrtarin e lartë të CDU/CSU, theksoi se çelja e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE gjatë mbledhjes së Këshillit Evropian në qershor do të ishte qasja më e mirë strategjike për vendin dhe për BE-në, duke pasur parasysh se Shqipëria i ka shumë të qarta sfidat që duhet t'i kapërcejë për përparimin në hapat e mëtejshëm të procesit



evropian. Ne i jemi thellësisht mirënjohës kancelares Merkel për vizionin e saj largpamës dhe mbështetjen e pakursyer për Shqipërinë, por edhe për rajonin e Ballkanit Perëndimor, edhe si nismëtare e Procesit të Berlinit, tha Ruçi.

Deputeti Hahn nënvizoi se vendimi për çeljen e negociatave në mbledhjen e qershorit të Këshillit Evropian, i shoqëruar nga kushte të qarta, është vendimi i duhur që duhet të merret për Shqipërinë. "Kjo do ta lehtësonte punën dhe përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë për integrimin evropian dhe progresin e vendit. Kjo do të ndihmojë që populli shqiptar të marrë një sinjal të qartë pozitiv për të ardhmen evropiane të Shqipërisë. Për këtë ne synojmë ta kemi edhe mbështetjen e popullit gjerman dhe të popujve të tjerë evropianë. Ky është vlerësimi im dhe i grupit politik që përfaqësoj për çeljen e negociatave me Shqipërinë", nënvizoi Hahn.

TIRANË, 24 MAJ - Hapja e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE gjatë Këshillit të qershorit do të ishte qasja më e mirë strategjike për vendin dhe për BE-në. Presidenti i Republikës, Ilir Meta, zhvilloi një takim me zëdhënësin e grupit parlamentar CDU/CSU për zgjerimin dhe çështjet e BE-së në Bundestagun gjerman, deputetin Florian Hahn. Presidenti Meta vlerësoi angazhimin e vazhdueshëm të Gjermanisë në të gjitha nivelet, në mbështetje të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE. Presidenti theksoi se çelja e

negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE gjatë Këshillit të qershorit do të ishte qasja më e mirë strategjike për vendin dhe për BE-në, duke pasur parasysh se Shqipëria i ka shumë të qarta sfidat që duhet të kapërcejë për përparimin në hapat e mëtejshëm të procesit.

Meta shtoi se procesi i negociatave për çdo kapitull është një mekanizëm efikas si për arritjen e rezultateve konkrete, po ashtu edhe për një monitorim më të afërt dhe bindës për çdo vend anëtar të Bashkimit Evropian.

Në përgjigje të interesit mbi

reformën në gjyqësor, presidenti Meta vuri në dukje se procesi i vettingut duhet ta nxjerrë më shumë në pah vlerësimin mbi nivelin e profesionalizmit dhe cilësinë e vendimeve gjyqësore, të cilat janë kyçe për besueshmërinë e publikut tek institucionet e drejtësisë.

Deputeti i Bundestagut gjerman, Florian Hahn, u takua edhe me kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi. Gjatë takimit kryetari Ruçi e falënderoi deputetin Hahn për mbështetjen e madhe e të veçantë të Qeverisë dhe Bundestagut të Gjermanisë, posaçërisht kancelares Merkel për Shqipërinë dhe progresin e Shqipërisë drejt integritetit

## Bushati: Vonesa e negociatave, kosto për të gjithë shqiptarët



TIRANË, 24 MAJ - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, tha se kostoja e çdo vonese për bllokim apo pengim të procesit të integritetit është kosto për të gjithë shqiptarët në rajon. "Kostoja e çdo vonese, bllokimi apo pengimi të procesit, nga mosdija apo nga mosdashja, është kosto për të gjithë shqiptarët në rajon. Reformat tona,

kryesisht në fushën e sundimit të së drejtës dhe thellimi i bashkëpunimit dypalësh me vendet anëtare në fusha si lufta kundër krim-it të organizuar, përbën një shembull e një faktor kontribues për sigurinë në të gjithë Ballkanin Perëndimor, si rrjedhojë ndikon drejtpërdrejt te shqiptarët kudo ku ata jetojnë në rajon", tha Bushati. Kërkesat dhe presioni i vendeve

anëtare shtohen, tha ministri, dhe është një test për të gjithë. "Disa prej nesh kanë zgjedhur t'i përgjigjen këtij presioni pozitiv me frikë, paranojë dhe bllokim e nxirje të imazhit të Shqipërisë me çdo kusht e në çdo rast, e të përdorin çdo platformë e tryezë ndërkombëtare ku i ka çuar vota e shqiptarëve, për ta nxirë perspektivën evropiane të shqiptarëve", tha Bushati.

## Kryeparlamentari Veseli sot viziton Shqipërinë

PRISHTINË, 24 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, do të udhëtojë sot (e premte) për në Shqipëri, i ftuar në

Lutjet e Mëngjesit, të cilat sivjet mbahen në kryeqytetin shqiptar. Ky aktivitet është organizuar nga Kuvendi i Republikës së

Shqipërisë, në të cilin pritet të marrin pjesë kryetarë të parlamenteve nga vendet e rajonit dhe të ftuar të tjerë të shumtë.

Gjatë vizitës në Shqipëri, kryeparlamentari Veseli do të pritet në takime të veçanta edhe nga krerët e shtetit.





# Krizat institucionale, pasojë e ambicieve të partive për ta mbajtur pushtetin

Për dhjetë vjet shtet në Kosovë asnjëra prej qeverive nuk ka arritur ta përfundojë mandatin e plotë qeverisës, kurse krizat institucionale kanë ardhur si pasojë e partive politike për ta ruajtur pushtetin. Kështu është thënë të enjten nga të pranishmit në tryezën e organizuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), ku është publikuar punimi me temë "Demokracia e Kosovës në rrezik? Paqëndrueshmëria e sistemit partiak, kohëzgjatja e Qeverisë dhe kriza institucionale në Kosovë"

koalicionet qeverisëse në Kosovë bëhen për poste dhe jo për politika të qëndrueshme. Për dhjetë vjet shtet në Kosovë asnjë parti politike nuk e ka mbajtur mandatin e plotë në pushtet", ka deklaruar Gashi.

Ndërsa analisti politik Naim Rashiti ka vlerësuar se krizat kanë lënë Kosovën pa projekte dhe plane ekonomike. Ai ka theksuar se në Kosovë ka mungesë të edukimit profesional të subjekteve politike. "Ne nuk jemi të vetëdijshëm se çfarë dëme kanë shkaktuar krizat politike të vitit 2015 dhe 2017. Këto kriza e kanë lënë Kosovën pa projekte e plane ekonomike. Ne kemi mungesë të edukimit profesional të subjekteve politike. Subjektet nuk i ndiejnë institucionet si tonat. Ata nuk e marrin seriozisht Kushtetutën, sepse nuk kanë qenë pjesë e punës së saj", ka thënë Rashiti.

Edhe analisti Arben Qirezi ka thënë se kriza ligjore dhe kushtetuese e bën sistemin politik komplet jofunksional në

Kosovë. "Shkelja e dispozitave ligjore, me qëllim të lejimit të prodhimit të institucioneve, ka ndodhur në vitin 2017 përmes një interpretimi të gabuar të Rregullores së Kuvendit. Partitë politike e kanë filluar mbledhjen konstituive, mirëpo ka përfunduar pas tre muajve", është shprehur Qirezi.

Ndërsa njohësja e proceseve politike, Jehona Lushaku, ka folur për përfshirjen e grave në pozita drejtuese. Ajo ka thënë se partitë politike kanë dështuar në inkuadrimitin e grave në vendim-marrje. "Kemi parë shpeshherë që brenda partive forumet janë vetëm formale dhe nuk ndikojnë në ndërtimin e kapaciteteve ndërpartiake. Ka qenë dështim total i partive politike në zgjedhjet e fundit për shkak të numrit të vogël të grave. Partitë politike kanë dështuar në integrimin e grave në vendim-marrje", është shprehur Lushaku.

Në fund të kësaj tryeze Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) ka dalë me disa rekomandime për

partitë politike dhe institucionet. D4D u ka rekomanduar partive në Kosovë se duhet të jenë më të vetëdijshme për nevojën e respektimit të normave elementare demokratike gjatë proceseve të ndjeshme të transformimit të pushtetit pas zgjedhjeve. Sipas këtij instituti, një pjesë e problemit në pazaret/bisedimet mbi koalicionet pas zgjedhjeve është tendencë e fokusimit në ndarjen e plaçkës politike, përfshirë këtu postet politike të nivelit të lartë, zgjerimin artificial të tyre në mënyrë që të kënaqen fraksionet e ndryshme dhe elektoratet klienteliste.

D4D rekomandon se akterët politikë duhet ta shfrytëzojnë kohën në opozitë më shumë që t'i drejtojnë organizatat e tyre politike kah ndërtimi i programeve dhe politikave strategjike afatgjata sesa të mendojnë se këto aspekte shumë të rëndësishme të politikës mund të lihen në dorë të fatit e improvizimit dhe të konsiderohen të rëndësishme vetëm pasi partia të ketë hyrë në Qeveri.

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 MAJ - Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) të enjten ka lansuar punimin me temë "Demokracia e Kosovës në rrezik? Paqëndrueshmëria e sistemit partiak, kohëzgjatja e Qeverisë dhe kriza institucionale në Kosovë". Me këtë rast, prezantuesi i këtij punimi, Krenar Gashi, ka thënë se krizat institucionale në Kosovë kanë ardhur si pasojë e ambicieve të partive politike për të mbajtur pushtetin.

Sipas tij, negociatat për koalicionet qeverisëse bëhen për poste dhe jo për politika të qëndrueshme. "Studimi bazohet në tri fusha shqetësuese: stabilitetin dhe kohëzgjatjen e qeverive, paqëndrueshmërinë zgjedhore dhe kohëzgjatjen e proceseve, përfshirë negociimin dhe formimin e koalicioneve qeverisëse pas zgjedhjeve. Krizat institucionale vijnë si pasojë e partive për ta mbajtur pushtetin. Është problem fakti i përzierjes së zyrës së presidentit në pazaret politike për qeverisje. Negociatat për



## Misioni i EULEX-it përfundon këtë vit

PRISHTINË, 24 MAJ - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX, do ta përfundojë mandatin deri në fund të këtij viti. Kështu është bërë me dije të enjten pas takimit që ka zhvilluar presidenti Hashim Thaçi me shefen e misionit të EULEX-it, Alexandra Papadopoulou. Gjatë këtij takimi presidenti Thaçi dhe shefja e EULEX-it në Kosovë kanë konstatuar se është

finalizuar teksti i letërkëmbimit ndërmjet Kosovës dhe institucioneve të Bashkimit Evropian, që parasheh përfundimin e misionit të EULEX-it në Kosovë në këtë vit.

Presidenti Thaçi e ka falënderuar ambasadorën Papadopoulou për qasjen konstruktive dhe për bashkëpunimin e misionit të EULEX-it dhe të gjitha institucioneve të Bashkimit Evropian.

Misioni i EULEX-it kishte ardhur në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Ky mision ishte krijuar që t'i ndihmojë institucionet, organet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në Kosovë. EULEX-i ishte misioni më i madh civil i themeluar në kuadër të politikave të përbashkëta për siguri dhe mbrojtje të Bashkimit Evropian.





Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

# Asociacioni për fazën finale

## - Presidenti Hashim Thaçi duhet ta udhëheqë fazën përfundimtare të dialogut

Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se lënia e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe për fazën finale të dialogut ndërmjet dy shteteve paraqet rrezik për Kosovën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka treguar se në këtë fazë Serbia mund të kërkojë kompetenca shtesë për asociacionin. Tahiri i ka ftuar subjektet politike për konsensus nacional rreth kësaj çështje. Ish-ministrja për Dialog ka treguar pse këtë fazë të dialogut duhet ta udhëheqë presidenti Hashim Thaçin dhe për këtë pikë u ka bërë thirrje partive për konsensus. Sipas Tahirit, kjo duhet të ndodhë për arsye kushtetuese dhe për shkak të përvojës së madhe në negociata që ka presidenti Thaçi

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 24 MAJ** - Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka ftuar institucionet e Kosovës që sa më shpejt ta formojnë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka deklaruar se lënia e formimit të Asociacionit për fazën finale të dialogut është e rrezikshme për Kosovën.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka bërë me dije se, nëse lejohet që asociacioni të bëhet pjesë e bisedimeve finale, Serbia mund të parashtrijë kërkesa shtesë. "Kosova duhet ta përshpejtojë zbatimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në mënyrë që të mos lejojë që kjo çështje të shkojë në pakon e marrëveshjes finale. Marrëveshja për asociacionin, të cilën ne e kemi arritur në Bruksel, nuk i jep kompetenca ekzekutive Asociacionit. Nëse vonohet Asociacioni dhe hynë në pakon e bisedimeve përfundimtare, ka rrezik që Serbia mund të bëjë kërkesa devijuese jashtë marrëveshjes", ka thënë Tahiri.

Ish-ministrja për Dialog ka deklaruar se për fazën përfundimtare të dialogut është i nevojshëm një konsensus nacional ndërmjet spektrit politik. "Mendoj se është me rëndësi të ketë një konsensus politik të gjerë. Kjo është e rëndësishme për faktin se janë vendime serioze dhe është proces që do të ketë rezultat historik, i cili lidhet me ardhmërinë evropiane të vendit tonë. Prandaj, po besoj se angazhimet që po bëhen kohën

e fundit, për të krijuar një fazë të gjerë të konsensusit, do t'i japin frytet e veta, në mënyrë që Kuvendi ta miratojë platformën dhe delegacionin e Republikës së Kosovës", ka thënë ajo.

Tahiri ka treguar edhe arsyet pse këto bisedime duhet t'i udhëheqë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. "Mendoj se presidenti Thaçi duhet ta udhëheqë delegacionin e Kosovës. Së pari, për arsye kushtetuese dhe, së dyti, për shkak të përvojës së madhe që ka në proceset negociatore", ka thënë Tahiri. Ajo ka sqaruar se delegacioni i Kosovës në këtë fazë nuk duhet të bëjë më kompromise me Serbinë. Sipas saj, maksimumi që Kosova ka bërë është pakoja e Ahtisarit. "Kosova ka bërë lëshime maksimale në bisedimet e Vjenës. Pakoja e Ahtisarit është maksimumi që Kosova ka mundur të bëjë lëshime, në të cilën komuniteti serb i ka dhënë të drejta më shumë se çdo komuniteti tjetër në Kosovë dhe, si rrjedhojë, komuniteti serb gëzon më së shumti të drejta në botë. Pra, për komunitetin serb duhet të zbatohet pakoja e Ahtisarit, e cila është edhe pjesë e Kushtetutës së Kosovës. Përtej pakos së Ahtisarit Kosova nuk mund të japë asgjë dhe nuk duhet të japë, sepse kjo pako është maksimumi që ka dhënë Kosova", ka thënë ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri.

**"Epoka e re":** Znj. Tahiri, së shpejti pritet të fillojë faza finale e dialogut Kosovë - Serbi. Sa është e përgatitur Kosova për këtë fazë kur dihet se ende nuk ka një konsensus të spektrit politik për këtë çështje?

**Tahiri:** Është me rëndësi që



dialogu të avancojë në fazën përfundimtare. Dialogu ndërmjet dy vendeve si proces ka qenë i gjatë dhe ka pasur mjaft rezultate të rëndësishme, sidomos për Kosovën. Kemi rikthyer sovranitetin në pjesën veriore të vendit në fusha relevante shtetërore. Në anën tjetër, faza përfundimtare ka peshë dhe do të ketë peshë në kuptimin që duhet të përmbillet me njohjen reciproke në mes të dy shteteve. Kjo fazë duhet t'i japë fund kapitullit të armiqësive ndërmjet dy vendeve dhe duhet të hapë një kapitull të paqes dhe marrëdhënieve ndërfqinjësore, në mënyrë që gjeneratave të reja mos t'u lëmë probleme ndërshtetërore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sa iu përket përgatitjeve, mendoj se është me rëndësi të ketë një konsensus politik të gjerë. Kjo është e rëndësishme për faktin se janë vendime serioze dhe është proces që do të ketë rezultate historike, i cili lidhet me ardhmërinë evropiane të vendit tonë. Prandaj, po besoj se angazhimet që po bëhen kohën e fundit - për të krijuar një fazë të gjerë të konsensusit - do t'i japin frytet e veta, në mënyrë që Kuvendi ta miratojë platformën dhe delegacionin e

Republikës së Kosovës. Mendoj se presidenti Thaçi duhet ta udhëheqë delegacionin e Kosovës. Së pari, për arsye kushtetuese dhe, së dyti, për shkak të përvojës së madhe që ka në proceset negociatore

**"Epoka e re":** Mirëpo opozita dhe një partner i koalicionit qeverisës e kundërshtojnë mundësinë që presidenti ta udhëheqë këtë proces?

**Tahiri:** Duhet të punohet për ndërtimin e konsensusit. Besoj se për këtë çështje duhet të vazhdojnë bisedimet ndërmjet subjekteve politike. Nuk mund të pres që të gjitha partitë parlamentare të bëhen pjesë e konsensusit megjithatë, kur bëhet një konsensus me bazë të gjerë, krijohet legjitimitet për delegacionin e Kosovës dhe atëherë normalisht se pozicioni dhe autoriteti i delegacionit duhet të jetë më i fuqishëm. Prandaj, duhet të punohet në atë drejtim. Po i dëgjoj edhe unë reagimet dhe kundërshtimet, mirëpo duhet të punohet në këtë drejtim. Kam besim se do të arrihet një konsensus, sepse kemi pasur konsensus edhe në kohën e bisedimeve në Rambuje, pastaj edhe në ato të Vjenës. Kështu që, duhet të

kemi edhe tani konsensus. Me gjithë mospajtimet apo kundërshtimet që kemi pasur, ne kemi arritur që për çështje madhore që kanë të bëjnë me interesa nacionale të ndërtohet një konsensus. Se çfarë do të jetë formula e konsensusit, se çfarë mund të kërkojnë këto parti opozitare si këmbim për këtë konsensus, ajo mbetet të diskutohet mes subjekteve politike.

**"Epoka e re":** Lëvizja Vetëvendosje së fundi ka dalë me qëndrim se nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që ju dhe presidenti Thaçi t'i udhëhiqni këto bisedime. Si e keni parë këtë qëndrim të tyre?

**Tahiri:** Nuk dua të shpenzoj kohë të merrem me deklaratat e Vetëvendosjes dhe liderit të saj. Ajo që unë si kryenegociatore jam angazhuar për këto shtatë vjet ka qenë mbrojtja e interesave shtetërore dhe rikthimi i sovranitetit të Kosovës në veri të vendit, të cilin nuk e kemi pasur para fillimit të dialogut. E dimë se para këtij procesi, Serbia me strukturat paralele ka qenë e pranishme në pjesën veriore të vendit. Kështu që, ky dialog ka mundësiar të shuhen strukturat paralele në fushat vitale shtetërore si në polici, gjykata



# të dialogut paraqet rrezik



njohjes reciproke ndërmjet dy shteteve. Edhe pse Serbia këtë gjë po e kundërshton, do të vijë në një moment kur do ta kuptojë se në Ballkan ka ndodhur një realitet i ri. Unë pres ndryshime në mendësinë e Serbisë, ndërsa për neve vijë e kuqe në këto bisedime është njohja reciproke, sepse vetëm kjo sjell paqe dhe stabilitet në raportet e dy shteteve dhe në rajon.

**"Epoka e re":** A do të jeni pjesë e delegacionit të Kosovës për këtë fazë të dialogut?

**Tahiri:** Këto procese duhet të zhvillohen mbi një konsensus më të gjerë. Pasi të arrihet ky konsensus dalin aktorët e procesit. Prandaj, nuk mund të paragjykoj. Pozicioni aktual politik yni dihet, pra jemi partnerë me PDK-në si Alternativë Demokratike e Kosovës. Pavarësisht se PDK-ja nuk ka arritur ta përmbushë obligimin e marrëveshjes që kemi pasur për koalicion, ne kemi shprehur mirëkuptim për pamundësinë e tyre. Pra, kjo do të varet se si do të zhvillohet ndërtimi i konsensusit dhe brenda koalicionit PDK-ADK do të thotë varet se si vijnë propozimet. Besoj se sot është herët të flasim për këtë çështje.

**"Epoka e re":** Tashmë Qeveria ka dorëzuar në Kuvend një platformë. Paraqet kjo bazë të mirë për fillimin e kësaj faze?

**Tahiri:** Kjo fare nuk është platformë e Qeverisë për arsye se Qeveria në atë platformë nuk ka marrë asnjë detyrë. Pra, ajo

është një platformë e Kuvendit, por se si ka ardhur ajo në tavolinën e Qeverisë nuk e di. Mirëpo, Qeveria e Kosovës ka një platformë shumë serioze, të cilën unë sa isha zëvendëskryeministre e kam dorëzuar në Bruksel në emër të Qeverisë. Këtë platformë e kanë botuar edhe mediet. Pra, ajo është një platformë gjithëpërfshirëse që mbështet në pesë tema kryesore: njohja reciproke ndërmjet dy shteteve; demarkacioni i kufirit ndërmjet dy shteteve; reparacionet e luftës që Serbia duhet t'ia bëjë Kosovës, ku përfshihet çështja e të pagjeturve, çështja e grave të dhunuara dhe të gjitha dëmet e tjera njerëzore dhe materiale; pastaj është suksesioni apo ndarja e pasurisë së ish-Jugosllavisë; në fund është një lloj garancie ndërkombëtare që nuk do të ketë përsëritje të gjenocidit të Serbisë në Kosovë. Kur të dyja shtetet kanë qenë në luftë ekzistojnë parimet e definuara në të drejtën ndërkombëtare se si arrihet paqja. Prandaj, kemi insistuar të respektohet e drejta ndërkombëtare në marrëveshjen përfundimtare.

**"Epoka e re":** Në opinionin publik shqetësimet janë se Kosova sërish do të bëjë kompromis për ta fituar njohjen nga Serbia dhe karrigen në OKB?

**Tahiri:** Kosova ka bërë lëshime maksimale në bisedimet e Vjenës. Pakoja e Ahtisarit është maksimumi që Kosova ka mundur të bëjë lëshime, në të

cilën komunitetit serb i ka dhënë të drejta më shumë se çdo komuniteti tjetër në Kosovë dhe, si rrjedhojë, komuniteti serb gëzon më së shumti të drejta në botë. Pra, për komunitetin serb duhet të zbatohet pakoja e Ahtisarit, e cila është edhe pjesë e Kushtetutës së Kosovës. Përtej pakos së Ahtisarit, Kosova nuk mund të japë asgjë dhe nuk duhet të japë, sepse kjo pako është maksimumi që ka dhënë Kosova.

**"Epoka e re":** Frika është se në kuadër të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, Serbia në këtë fazë do të kërkojë të drejta shtesë për serbët?

**Tahiri:** Pikërisht për këtë Asociacioni duhet të zbatohet sa më shpejt. Derisa bëhet hartimi i statutit të Asociacionit, Serbia duhet t'i plotësojë obligimet e veta, duke zbatuar marrëveshjen për energjinë, ta lejojë hapjen e urës së Ibrit, t'i kthejë regjistrat kadastralë, ta bëjë njohjen e diplomave dhe t'i kryejë obligimet e tjera që i takojnë. Ndërsa Kosova duhet ta përshpejtojë zbatimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në mënyrë që të mos lejojë që kjo çështje të shkojë në pakon e marrëveshjes finale. Marrëveshja për asociacionin, të cilën ne e kemi arritur në Bruksel, nuk i jep kompetenca ekzekutive asociacionit. Nëse vonohet asociacioni dhe hynë në pakon e bisedimeve përfundimtare, ka rrezik që Serbia mund të bëjë kërkesa devijuese jashtë marrëveshjes.

dhe dogana. Tani në këto fusha i kemi institucionet tona shtetërore të vendit dhe ky është një sukses i madh. Pastaj, falë këtij procesi kemi mbyllur

kufirin me Serbinë, i cili ka qenë i hapur, meqenëse pikëkalimet kanë qenë të djegur. Natyrisht, ka ende punë dhe faza finale e këtij dialogu duhet të jetë vulë e

## QKUK-ja bëhet me repart të ri të shërbimit intensiv

Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) të enjten është përruar Shërbimi i ri Intensiv, i cili është pajisur me 27 shtretër dhe tani ka kapacitet për 1 000 pacientë gjatë vitit

**PRISHTINË, 24 MAJ (ER)** - Të enjten është përruar Shërbimi i ri Intensiv në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se repartit

i Shërbimit Intensiv për vite me radhë ka pasur më shumë kërkesa sesa që ka mundur t'i përballojë. Sipas ministrit Ismaili, me vetëm 14 shtretër dhe pa infrastrukturë të duhur, kjo njësi e



kujdesit dhe monitorimit 24 orësh për jetën e pacientëve, ka qenë kokëçarje e sektorit shëndetësor. "Fatkeqësisht, jo rrallë historitë e qytetarëve tanë kanë pasur edhe fund të hidhur si pasojë e mungesës së shtretërve në Intensivë. Sot jam shumë i lumtur që kësaj historie i erdhi

fundi. Me 27 shtretër, e pajisur me aparaturë moderne, me staf të shtuar profesional, është i gatshëm Shërbimi i ri Intensiv në QKUK", ka thënë Ismaili. Ai ka falënderuar Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim për investimin e dy milionë eurove në këtë repart, i cili do të

mundë t'i trajtojë mbi 1 000 pacientë gjatë vitit, dyfishin e numrit të deritanishëm. "Shpresoj se qytetarët tanë të kenë sa më pak nevojë për këtë repart, mirëpo është detyrë dhe obligim yni që t'u gjendemi pranë kur ata kanë më së shumti nevojë", ka thënë ministri Ismaili.



# Shpallen fajtorë të akuzuarit në rastin 'Medicus'

PRISHTINË, 24 MAJ - Gjykata Themelore në Prishtinë i ka shpallur fajtorë dhe i ka dënuar me burgim të akuzuarit në rastin e njohur "Medicus" për trafikim të qenieve njerëzore dhe krim të organizuar. Pronarit të klinikës, mjekut Lutfi Dervishi, iu shqiptua dënimi me 7 vjet e gjashtë muaj burgim si dhe 8 000 euro gjobë, kurse të akuzuarit Sokol Hajdini iu shqiptua dënimi me 1 vit burgim.

Kryetarja e trupit gjykues, Franciska Fiser, gjatë leximit të vendimit ka thënë se Lutfi Dervishi ka qenë pjesëmarrës në disa operacione të transplantimit, pavarësisht se ai e kishte ditur se Klinika "Medicus" nuk kishte veprime, sipas trupit gjykues, ishin kryer pavarësisht se transplantimi ka qenë i ndaluar. Gjyqtarja Fiser, duke arsyetuar vendimin, ka thënë se Lutfi Dervishi, në bashkëpunim me persona të tjerë, nëpërmjet mashtrimit dhe keqpërdorimit të pozitës së ndjeshme, kanë rekrutuar së paku shtatë persona, të cilët i kanë strehuar dhe operuar në Klinikën "Medicus". Sipas gjykatës, kjo ishte bërë për



arsye të marrjes së veshkave, të cilat, pas marrjes, u janë transplantuar personave pranues. Lutfi Dervishi akuzohej për trafikim të qenieve njerëzore dhe krim të organizuar, kurse Sokol Hajdini akuzohej për lëndim të rëndë trupor. Nën akuzat për transplantim të paligjshëm të veshkës, gjatë

seancave gjyqësore, i akuzuari Lutfi Dervishi kishte deklaruar se transplantimi i veshkës është veprë humane, e jo penale. Sipas tij, në gjithë botën bëhen mijëra transplantime, por askush nuk ndiqet penalisht. Ndërkaq Sokol Hajdini, i cili e kishte mohuar akuzën, kishte deklaruar se ai me veprimet e

vet nuk kishte asnjëherë qëllim të binte ndesh me ligjin apo t'i shkaktonte lëndime trupore ndokujt.

Gjatë seancës së kaluar fjalën përfundimtare e kanë dhënë palët mbrojtëse, duke e kundërshtuar aktakuzën e ngritur nga ana e Prokurorisë. Prokurorja e rastit, Valeria Bolici, në fjalën

përfundimtare kishte kërkuar nga gjykata ta konfirmojë përgjegjësinë penale të Dervishit dhe të Sokolit dhe t'i dënojë sipas dënimeve që parashihen me ligj.

Lutfi Dervishi ishte pronar i Klinikës "Medicus" në të cilën, sipas hetimeve, pretendohet se është kryer transplantimi i veshkave.

Pjesë e këtij gjykimi ishte edhe Arban Dervishi, djali i Lutfi Dervishit, por procedura ndaj tij është ndarë si lëndë e veçuar, ngaqë ai ndodhet në arrati.

Urologu Lutfi Dervishi ishte dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me 8 vjet burg në vitin 2013, ndërsa Sokol Hajdini me 3 vjet. Gjykata e Apelit më pas ia kishte vërtetuar dënimin Dervishit, ndërsa Hajdinit ia kishte shtuar vitet e dënimit me burg nga 3, në 5 vjet.

Ndryshe, në Kosovë nuk ka ligj për transplantim të organeve. Një draftligj ishte hartuar nga Qeveria dhe proceduar më pas në Kuvend, por i njëjti ishte bllokuar nga misionet ndërkombëtare, ku një prej arsyeve të bllokimit të tij ishte përmendur pikërisht rasti i njohur "Medicus". (REL)

## Kërkohet zbatim më efikas i strategjisë shtetërore për riintegrim

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 24 MAJ - Në kuadër të Strategjisë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2018-2022, si dhe Planit të Veprimit 2018-2020, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë mbajtur të enjten një konferencë për medie, në të cilën kanë folur për aktivitetet e riintegritimit 2018.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka thënë se politika jonë shtetërore e riintegritimit të personave të riatdhesuar vlerësohet edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë si një nga politikat më të avancuara për rajonin e Ballkanit Perëndimor. "Ne si Qeveri e Republikës së Kosovës krenohemi që jemi një nga shembujt më të mirë në rajon dhe më gjerë për zbatimin e kësaj politike", ka thënë Zeka. Ai ka shtuar se zhvillimi i politikës së riintegritimit të personave të riatdhesuar është bërë si



rezultat i kërkesave nga dialoгу për liberalizim të vizave me BE-në, si dhe nga kërkesat për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. "Serioziteti i shtetit tonë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës është

treguar duke krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë, krijimin e bazës strategjike dhe ligjore për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe, përveç kësaj, edhe përmes alokimit të fondeve nga buxheti i Kosovës në vlerë rreth

tre milionë euro në vit. Duhet theksuar se kjo vlerë e fondeve është e vogël duke pasur parasysh prioritetet dhe nevojat për investime në shumë fusha në Kosovë, megjithatë tregon seriozitetin dhe përkushtimin që qytetarët tanë

të riatdhesuar të kenë mundësi të riintegritimit të qëndrueshëm në Kosovë, sepse ata janë potencialet e zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale në Republikën e Kosovës", ka thënë zëvendësministri Zeka.

Ai ka falënderuar partnerët ndërkombëtarë të cilët kanë ofruar përkrahje të vazhdueshme për zbatimin e politikave të ndryshme shtetërore, në veçanti të politikës së riintegritimit të personave të riatdhesuar. "Sukseset dhe progresi që vlerësohet nga mekanizmat evropianë dhe ndërkombëtarë janë arritje dhe rezultat i punës sonë të përbashkët dhe bashkëpunimit të shkëlqyer që kemi pasur. Besoj se ky bashkëpunim do të vazhdojë në të ardhmen me qëllim të zbatimit sa më efikas të strategjisë së re për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar", është shprehur ai. Zëvendësministri Zeka ka shtuar se është me rëndësi të theksohet se në vitet e fundit Kosova ka kaluar nga masat për ndihmë emergjente në masat për riintegrim të qëndrueshëm.



Hapet ekspozita për kontributin e ish-presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova për shtetformimin e Kosovës

# Presidenti Thaçi dekoron ish-presidentin Rugova

Presidenti Hashim Thaçi e ka pritur të enjten në takim gruan dhe fëmijët e ish-presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, të cilëve ua ka dorëzuar Medaljen Presidenciale të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë për ish-presidentin Rugova

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar ish-presidentin e ndjerë Ibrahim Rugova me Medaljen Presidenciale Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë. "Medalja Presidenciale për 10-vjetorin e Pavarësisë i jepet presidentit Ibrahim Rugova për kontributin për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka thënë Thaçi kur ia ka dorëzuar medaljen gruas së ish-presidentit Ibrahim Rugova.

Të pranishëm në këtë takim ishin gruaja e ish-presidentit Rugova dhe tre fëmijët e tij. Kjo pritje nga presidenti Thaçi është bërë në Ditën e Presidentit, më 24 Maj. Po të enjten presidenti Thaçi ka marrë pjesë në hapjen e ekspozitës për kontributin e ish-presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova për shtetformimin e

Kosovës, të organizuar nga Muzeu i Kosovës.

Presidenti Thaçi ka thënë se kushdo që do ta vizitojë këtë ekspozitë do ta ketë mundësinë të bëjë një kthim apo një udhëtim në kohë të viteve të rënda dhe tragjike të vendit, të cilat pashmangshëm lidhen me emrin e ish-presidentit Rugova. Lëvizja për pavarësinë e Kosovës, sipas presidentit Thaçi, si në dimensionin politik, po ashtu dhe në atë ushtarak, bëri bashkë politikanë, intelektualë, ushtarakë, gra dhe burra, pleq dhe të rinj, me një qëllim të vetëm. "Këtij populli liridashës dhe kryengritës, i cili ka qenë dhe mbetet populli më proamerikan dhe më proerëndimor në këto anë të Evropës, t'i jepet e drejta për të qenë i lirë dhe për ta pasur shtetin e vet", u shpreh presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka theksuar se duke



qenë bashkë të gjithë, në emër të Kosovës, u arrit përkrahja dhe mbështetja e botës perëndimore për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës. "Presidenti Rugova dhe unë kemi qenë së bashku në Konferencën e Rambujesë, pastaj në të gjitha zhvillimet e pasluftës, edhe në Ekipin e Unitetit. Së bashku përgatitëm

Kosovën për t'u bërë e pavarur. Së bashku ishim në Uashington, në Bruksel, në Vatikan e në kryeqendra të tjera botërore, për ta bindur botën për të drejtën tonë për liri dhe shtet. Ndërtuam miqësi të përjetshme me partnerët tanë strategjikë", ka thënë ai.

Para anëtarëve të familjes Rugova dhe përfaqësuesve të tjerë shtetërorë, presidenti Thaçi ka thënë se pavarësia e Kosovës nuk erdhi si incident apo aksident politik, por u fitua me vetëmohim dhe sakrificë të pashoqe. Ai ka shtuar se mosbindja civile kundër Serbisë ishte monumentale për lëvizjen politike botërore, derisa UÇK-ja ishte lëvizja çlirimtare më e suksesshme politike dhe ushtarake në historinë botërore. "Kombinimi i këtyre dy komponentëve të lëvizjes kombëtare nuk kishte si të mos rezultonte me unitetin qytetar, me përkrahjen masive ndërkombëtare, për të kulmuar me lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi në hapjen e kësaj ekspozite.

I pari i vendit ka theksuar se Ibrahim Rugova ishte njeri

komunikues, i dialogut dhe i negociatave, njeri i durimit dhe i pajtimit. "Në parti e koncepte të ndryshme politike, qëllimi ynë madhor ishte realizimi i vullnetit të popullit tonë për liri dhe pavarësi të Kosovës. Prandaj ndihem mirë për këtë bashkëpunim. Sot çdo parti dhe lider politik duhet ta shikojë të ardhmen stabile dhe perspektivën euroatlantike të Kosovës, para interesave të adresave të caktuara të partive politike", ka shtuar ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se sot çdo qytetar i Kosovës kudo që jeton, në Kosovë apo diasporë, është liridashës dhe çlirimtar, derisa Kosova është shtet, ka simbolet e veta: flamurin, himnin, stemën. "Kosova ka identitet kombëtar dhe shtetëror. Kosova ka identitet evropian. Secili duhet të ndihet krenar me Kosovën. Shteti i Kosovës është mbi të gjithë ne. Të gjithë duhet të jemi në shërbim të vendit tonë", ka thënë Thaçi, duke i ka përgëzuar organizatorët për këtë ekspozitë, e cila, pos të tjerash, shpreh vlerësim institucional për rolin historik të presidentit Rugova.



## Genevieve Darrieussecq viziton Kosovën

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Sekretarja e Shtetit në Ministrinë e Forcave të Armatosura të Francës, Genevieve Darrieussecq, do të qëndrojë për vizitë në Prishtinë më 1 qershor. Sipas një njoftimi të Ambasadës së Francës në Kosovë, Darrieussecq do ta

kryesojë ceremoninë e homazheve në monumentin kushtuar ushtarëve francezë të vdekur në Kosovë që ndodhet në varrezat e Arbërisë (te komuna e re).

Sekretarja e Shtetit në Ministrinë e Forcave të Armatosura të Francës do të

ketë më pas takime të ndara me kryeministrin Ramush Haradinaj, ministrin e FSK-së Rustem Berisha, për të diskutuar për marrëdhëniet midis Kosovës dhe Francës dhe për perspektivat e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.





# Reformat e ministrit Reçica përkrahen nga Banka Botërore

**EPOKA  
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 MAJ - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të enjten në takim përfaqësues të Bankës Botërore, të kryesuar nga Marco Mantovanelli, menaxher i Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoni në Regionin e Evropës dhe Azisë, si dhe ekipin e tij.

Ministri Reçica i ka njoftuar përfaqësuesit e Bankës Botërore për angazhimet aktuale të MPMS-së dhe rreth ecurisë së procesit sa i përket reformës së sistemit pensional në Republikën e Kosovës. Ai ka thënë se është duke u planifikuar reformë rrënjësore ligjore dhe të shërbimeve të cilat ofrohen. "Jemi shumë të përkushtuar, që deri në fund të vitit ta kemi konceptdokumentin për reformën pensionale, i cili, përpos që parasheh hartimin e ligjit të ri të pensioneve, do ta përfshijë edhe reformën e shërbimeve", ka deklaruar Reçica. Gjithashtu, ministri ka treguar rreth përpjekjeve që po bën



MPMS për respektim të të drejtave të punëtorëve, me ç'rast ka pohuar se MPMS-ja ka dërguar për miratim në Qeveri konceptdokumentin e ligjit të ri të punës, i cili do të rregullojë

një varg çështjesh sa iu përket të drejtave të punëtorëve. Në kuadër të kësaj, ministri Reçica ka theksuar se rëndësi të veçantë do t'u kushtohet nënave lehonë, të drejtat e të

cilave parashihen të trajtohen me një ligj të veçantë dhe për herë të parë parashihet të bëhet edhe pushimi prindëror. Nga përfaqësuesit e Bankës Botërore ministri mori konfir-

mimin për vazhdim të mbështetjes së plotë për reformat dhe nismat e ndërmarra si dhe për koordinim të përbashkët në çështje për të cilat MPMS-ja ka nevojë për ndihmë.

## BQK-ja konfirmon përkrahjen e projekteve që hapin vende të reja të punës

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur të enjten në takim ministrin e Infrastrukturës, Pal Lekaj. Temë e këtij takimi kanë qenë zhvillimet e përgjithshme në sektorin bankar dhe mbështetja që BQK-ja mund të japë për realizimin e projekteve infrastrukturore.

Guvernatori Fehmi Mehmeti ka njoftuar ministrin Lekaj me trendët e përgjithshëm në sektorin financiar në Kosovë dhe punën që po bënë BQK-ja për zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij sektori. "Ne si BQK jemi të angazhuar ta mbështesim zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin financiar dhe bankar në Kosovë. Gjithashtu, jemi të angazhuar t'i mbështesim institucionet e Kosovës për realizimin e projekteve që kanë për qëllim zhvillimin e ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës", ka thënë guvernatori Mehmeti.

Ndërsa ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka falënderuar guvernatorin Mehmeti për mbështetjen për realizimin e projekteve të ndryshme infrastrukturore.





# Importi i mallrave në Kosovë arrin vlerën mbi 270 milionë euro

Sipas ASK-së, eksporti mbulon importin me 9.4 %.

"Eksporti i mallrave në muajin prill 2018 kishte vlerën 25.5 milionë euro, ndërsa importi 270.3 milionë euro, që është një rënie prej 18.2 % për eksport dhe një rritje prej 7.3 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017.

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 24 MAJ** - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin prill 2018. Të dhënat nga tregtia e jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 10.9 % në muajin prill 2018 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 244.7 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 220.6 milionë eurosh në vitin 2017. Sipas ASK-së, eksporti mbulon importin me 9.4 %. "Eksporti i mallrave në muajin prill 2018 kishte vlerën 25.5 milionë euro, ndërsa importi 270.3 milionë euro, që është një rënie prej 18.2 % për eksport dhe një rritje prej 7.3 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 28.8 % të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 15.5 % produktet minerale; 15.1 % plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10.3 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 4.8 % artikujt e ndryshëm të prodhuar; 4.6 % produktet bimore; 3.9 % lëkura dhe artikujt prej saj; 3.9 % tekstili dhe artikujt prej tij; 3 % makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike etj", është thënë në komunikatën e ASK-së.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 13.9 % të importit e përbëjnë produktet minerale; 12.9 % makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 12.6 % ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10.4 % metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 8.6 % produktet e industrisë kimike; 7.3 % plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 7.2 % mjetet e transportit; 5.2 % produktet bimore etj. "Eksportet e Kosovës në vendet

e BE-së arritën në 8.1 milionë euro, ose rreth 31.8 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 28.8 %. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (8.1 %), Britania e Madhe (4.9 %), Holanda (4.3 %), Italia (2.8 %) dhe Bullgaria (2.3 %)", theksohet në komunikatën e ASK-së.

Kurse importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 115.4 milionë euro, ose 42.7 % e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 6.4 %. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (11.3 %), Italia (5.7 %), Greqia (4.1 %), Sllovenia (2.8 %), Polonia (2.8 %) etj. "Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s në muajin prill 2018 arritën në 13.8 milionë euro, ose 54.1 % të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej 17.2 %. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (21.7 %), Maqedonia (14.9 %), Serbia (9.1 %) dhe Mali i Zi (5.9 %)", është bërë me dije në këtë komunikatë.

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin prill 2018 arritën në 72.4 milionë euro, ose 26.8 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 2.3 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (13.7 %), Maqedonia (5.3 %), Shqipëria (4.9 %) dhe B&H (2.4 %). "Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 3.5 milionë euro, ose 14.1 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: Zvicra (8.2 %) dhe Turqia (3.3 %). "Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 82.4 milionë euro, ose 30.5 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (11.4 %) dhe Kina (6.9 %)", është thënë në komunikatën e ASK-së.



## OEK-u u bënë apel prodhuesve dhe eksportuesve vendorë

**PRISHTINË, 24 MAJ (ER)** - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) i ka ftuar kompanitë prodhuese dhe eksportuese të Kosovës, që eksportojnë mallra me origjinë të Kosovës në Zvicër dhe Norvegji dhe që dëshirojnë të përfitojnë nga skema e sistemit gjeneral të preferencave, ta plotësojnë formularin i cili gjendet si informatë në uebfaqen e Doganës së Kosovës (<https://dogana.rks.gov.net/per-biznese/cert-e-origjines-per-zvicrren-dhe-norvegjine/>) dhe të njëjtën të paraqesin pranë sektorit të

originës, në zyrat e Doganës së Kosovës në Prishtinë në mënyrë që të regjistrohen në sistem.

Pas regjistrimit kompanitë do ta marrin numrin e regjistrimit të cilin duhet ta vendosni tek deklarimi fatural. Ky sistem u mundëson eksportuesve kosovarë që eksportojnë mallra në Zvicër dhe Norvegji që të regjistrohen nga Dogana e Kosovës në këtë sistem, pastaj të kenë mundësi që për mallrat që i prodhojnë dhe eksportojnë në këto vende të lëshojnë vetëdeklarata faturë

mbi origjinën, pa pasur nevojë të pajisen me FORMA A. Afati i fundit për aplikim është 30 qershor 2018. Pas kësaj date kompanitë eksportuese në këto vende, nëse nuk janë të regjistruara në sistem, do t'i nënshtrohen taksës doganore nga Zvicra dhe Norvegjia", është thënë në njoftimin e OEK-ut.

Deri më tani janë regjistruar një numër shumë i vogël i kompanive, mirëpo mundësitë për zgjerim dhe përfitim janë shumë më të mëdha.

## Ministri Beqaj përfaqëson Kosovën në dialogun ekonomik dhe financiar



**PRISHTINË, 24 MAJ (ER)** - Me ftesë të Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian, ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, do ta përfaqësojë Kosovën në Dialogun Ekonomik dhe Financiar në

mes të Bashkimit Evropian, vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, në nivel politik që mbahet në Bruksel. Fokusi i këtij dialogu do të jetë me temë "Forcimi i kornizës fiskale si kontribut në konvergjencën ekonomike".

Ministri Beqaj në këtë takim do ta shpalosë përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të ndjekur një strategji konservatore të politikës makroekonomike, duke synuar nivelet e ulëta të deficitit buxhetor dhe borxhit publik.




## Konfiskohen mbi 700 kg nënprodukte të prishura të mishit

FERIZAJ, 24 MAJ (ER) - Inspektorati Komunal, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë konfiskuar dhe asgjësuar në Ferizaj një sasi të madhe të nënprodukteve të mishit dhe qumështit, të cilat, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të transportit, kanë rezultuar të prishura. Komuna e Ferizajt ka njoftuar se

sasia e konfiskuar dhe asgjësuar është rreth 700 kilogramë, të cilët janë gjetur në dy automjete transportuese.

Ridvan Berisha, koordinatori i Inspektoratit Komunal, ka thënë se aksioni për kontrollin e cilësisë së mishit dhe produkteve të tjera që ofrohen në treg po vazhdon me inspektime në baza ditore.



## Në Prishtinë ka filluar punën Akademia e Animacionit

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Në Komunën e Prishtinës ka filluar punën Akademia e Animacionit në të cilën janë të përfshirë

shtatë nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të Prishtinës. Për tre muaj këta nxënës do të mësojnë për skenar (shkrimin e

tregimit), regji dhe montazh, dizajn i animacionit, principet e animacionit, bazat e softuerëve dhe audio.



## Ndihmohen 400 familje të varfra në Mitrovicë

MITROVICË, 24 MAJ (ER) - Shoqata "Qatar Charity-Kosova" përmes një donacioni ka ndihmuar të enjten 400 familje skamnore të Mitrovicës. Drejtorja për Integritim Evropian dhe Mirëqenie Sociale, sektori i Qendrës për Punë Sociale, në bashkëpunim me Shoqatën "Qatar Charity-Kosova", kanë identifikuar familjet në nevojë dhe i kanë ndihmuar ato me

nga një pako ushqimore për secilën familje.

Drejtoresha për Integritim Evropian dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Mitrovicës, Nazane Kërveshi, ka falënderuar Shoqatën Humanitare "Qatar Charity-Kosova" për veprimet e tyre humane të treguar në vazhdimësi për qytetarët mitrovicas. "Ne po përpiqemi t'u

ndihmojmë nevojtarëve brenda mundësive tona, por me këtë buxhet që kemi është e pamundur t'i plotësojmë të gjitha kërkesat e tyre. Prandaj, ju falënderoj për kontributin tuaj për t'i ndihmuar familjet skamnore të Mitrovicës", ka thënë Kërveshi. Ajo ka theksuar se ndihmat e tilla e zbusin gjendjen e rëndë sociale në të cilën ndodhen këto familje.

## 'Zgjimi' i Gremnikut shënon ditën e shkollës

Klinë, 24 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Arben Limani, kanë marrë pjesë të enjten në manifestimin e Ditës së Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Zgjimi" në fshatin Gremnik të kësaj komune. Duke iu drejtuar nxënësve, mësimitdhënësve dhe të pranishmëve, Elezaj ka theksuar se dita e kësaj shkolle është e veçantë jo vetëm për nxënësit dhe mësimitdhënësit, por edhe për qytetarët e Klinës. "Ndihej i lumtur sot, në këtë ditë të madhe feste për nxënësit, mësimitdhënësit dhe qytetarët e

Gremnikut dhe më gjerë, që jam me ju për ta kujtuar dhe përjetuar bashkërisht një ngjarje me rëndësi historike për zhvillimin e arsimit në këto anë. Çdo njeri dhe çdo institucion e ka një motiv për më shumë punë, për më shumë angazhim, për më shumë suksese dhe të arritura. Përparimi për një të ardhme më të sigurt ka nevojë për idetë dhe energjitë tuaja. Këto energji që gjeneron shkolla do të motivojnë për arsimimin dhe edukimin e këtyre brezave që janë begatitë më e çmuar e jona, janë e ardhmja jonë", ka thënë Elezaj.



## Vazhdojnë projektet infrastrukturore në Rahovec

RAHOVEC, 24 MAJ (ER) - Në Komunën e Rahovecit janë duke vazhduar punimet për realizimin e projekteve infrastrukturore. Ecurinë e punimeve nga afër e ka vëzhguar edhe kryetari i komunës,

Smajl Latifi, i cili ishte i shoqëruar nga drejtori i Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi. Në realizimin e këtyre projekteve është duke u bërë asfaltimi i rrugës Drenoc-Senoc-Pastasellë dhe Polluzhë,

rrethrotullimi në hyrje të Rahovecit, në udhëkryqin Rahovec-Malishevë, rrethrotullimi në hyrje të Rahovecit, në udhëkryqin Rahovec-Krushë e Madhe dhe Rahovec-Suharekë.





## Babai mbyt djalin 14 vjeç

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Një 14-vjeçar nga fshati Karaçevë i Komunës së Kamenicës ka vdekur si pasojë e dhunës së ushtruar nga babai i tij. Lajmin e ka bërë me dije të enjten Policia e Kosovës. Sipas njoftimit të PK-së, në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kamenicë fëmija është sjellë pa shenja jete. "Pas hetimeve të para në vendin e ngjarjes nga njësitet e hetimeve rajonale të Policisë së Kosovës dhe prokurori i shtetit, dyshohet se, si pasojë e dhunës fizike, rrahjes së ushtruar nga i dyshuari, prindi i viktimës G. B., shqiptar, shtetas i Kosovës, lindur më 1958, si pasojë e goditjeve me mjete të forta, besohet shkop druri, fëmija ka ndërruar jetë", është thënë në njoftimin e policisë.

Motivet e kësaj ngjarjeje besohet se lidhen me faktin se fëmija ka shpenzuar disa para të prindit pa dijeninë e tij. Ndaj kësaj vrasje kanë reaguar presidenti i

Kosovës, Hashim Thaçi dhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri. Thaçi nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka shkruar se është i pikëlluar nga vrasja e 14-vjeçarit nga Kamenica. "Jam i prekur thellë nga vrasja e të miturit 14-vjeçar nga Karaçeva e Komunës së Kamenicës. Dhuna në familje është e patolerueshme dhe në kundërshtim me vlerat që kemi krijuar si shoqëri dhe kundër traditës sonë. Familja gjithmonë ka qenë e shenjtë dhe e tillë duhet të mbetet, të kultivohet dhe ruhet nga të gjithë. Ky rast i rëndë duhet ta zgjojë ndërgjegjen e të gjithëve, për të punuar më shumë dhe më vendosmërisht për të parandaluar çdo formë të dhunës në familje", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se rastet si ky i Kamenicës duhet të marrin fund. "Ka gjëra për të cilat edhe nëse nuk flet përgjegjësia që bar-



tim, flet ana shpirtërore që ndajmë si njerëz, si familjarë dhe si qytetarë. Rasti tragjik i humbjes së jetës së të riut nga Karaçeva e Kamenicës duhet të na nxisë më shumë se kurrë për ta fuqizuar

komunikimin komunitar dhe institucional, që dhuna në familje dhe në çfarëdo rrethane të marrë fund. Çdo gjë është e kompensueshme, përveç jetës së njeriut. Vetëdija jonë shoqërore

kundër dhunës duhet të kalojë në nivel kuptimplotë dhe të arrijë efekte edukuese e parandaluese. Ky është obligim i të gjithë neve", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

## Kosumi fton studentët të bëhen pjesë e programit Erasmus+

GJILAN, 24 MAJ (ER) - Rektori i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, Bajram Kosumi, të enjten ka marrë pjesë në ditën informuese të programit Erasmus+ për thirrjen për aplikim. Erasmus+ është program arsimor i Bashkimit Evropian që synon modernizimin e sistemeve arsimore dhe përshtatjen e tyre me sistemet e Unionit Evropian. Rektori Kosumi ka falënderuar zyrën e BE-së dhe zyrën e Erasmus+ për sesionin informues, kurse ka thënë se universitetin që drejton ka një përvojë të lakmueshme në projekte ndërkombëtare, veçanërisht në projektet Erasmus. Gjithashtu, rektori Kosumi ka inkurajuar të gjithë studentët dhe stafin akademik të aplikojnë dhe të



bëhen pjesë e mundësive që ofron Erasmus+.

Ndërsa prorektori për bashkëpunim ndërkombëtar, Dukagjin Leka, gjatë sesionit informues që temë diskutimi ka

pasur "Ngritjen e cilësisë së arsimit në Kosovë, përkrahja e BE-së për arsimin dhe programi Erasmus+ si përkrahje për ngritje të cilësisë së arsimit", ka thënë se projektet Erasmus+

për UKZ-në kanë rëndësi të madhe. Prorektori Leka ka folur edhe për projektet e tjera që Universiteti "Kadri Zeka" ka me institucionet ndërkombëtare. Rasa Jautakaite-Tunaitiene nga

zyra e BE-së në Kosovë ka thënë se kjo ditë informative e programit Erasmus+ është një mundësi e mirë për të gjithë, për t'i parë mundësitë që ofron Bashkimi Evropian për ndërtimin dhe zhvillimin e standardeve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Ndërsa Blerina Zjaqa nga zyra e Erasmus+ ka informuar të pranishmit rreth programit Erasmus+. Ajo ka theksuar se disa nga mundësitë e programit Erasmus+ për universitetet e Kosovës janë ngritja e cilësisë në arsimin e lartë në shumë dimensione, duke përfshirë edhe mundësinë e mobilitetit sa më të madh akademik dhe studentor brenda hapësirës regjionale, sidomos asaj evropiane.

## Haradinaj nderon dëshmorët në Glogjan

GLOGJAN, 24 MAJ (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të enjten ka bërë homazhe në Glogjan dhe Kodrali të Deçanit, me rastin e shënimit të 24 majit, Ditës së Batalionit Gardist dhe rënies së dëshmorëve të kombit, të Batalionit Gardist "Shkëlzen Haradinaj" të Zonës Operative të Dukagjinit.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se sot kujtohen të rënë për liri në trekëndëshin Kosovë - Shqipëri - Mal i Zi, të Batalionit Gardist të atëher-

shëm dhe gjithë bashkëluftëtarët që kanë rënë për liri. "Batalioni Gardist ishte një prej njësive që ka kryer punë shumë të vështira në kohë të luftës, por edhe kujdesin ndaj të plagosurve", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ai ka kujtuar se operacioni kur ranë këta dëshmorë ishte më i vështiri, më i mundimshmi për të bartur të plagosur nga zonat e luftës drejt Shqipërisë përmes një terreni të bjeshkëve dhe kushteve atmosferike të vështira dhe në pritë të armikut.





## Merkeli viziton Kinën

**BERLIN, 24 MAJ** - Kancelarja gjermane Angela Merkel do ta takojë në Pekin kryeministrin e Kinës, Li Keqiang, me të cilin do të diskutojë për rëndësinë e dialogut midis Kinës dhe

Gjermanisë në kohën e shqetësimeve për tregtinë me Shtetet e Bashkuara dhe tërheqjes së Uashingtonit nga marrëveshja bërthamore me Iranin. Merkel ka theksuar edhe

rëndësinë për konsultime të rregullta me Kinën mbi çështjet e të drejtave të njeriut, shkencën dhe teknologjinë. Kjo është vizita e parë e Merkelit në Kinë, prejse ajo ka formuar qeverinë e

re. Kjo vizitë pason udhëtimet e saj në Uashington, ku ka takuar presidentin amerikan Donald Trump dhe në Soçi të Rusisë, ku ka takuar presidentin rus Vladimir Putin.



# Donald Trumpi anulon takimin me Kim Jong Unin

Në letrën e tij drejtuar udhëheqësit koreano-verior, presidenti Donald Trump shkruan se revoltimi dhe armiqësia e hapur e shfaqur në deklaratat e fundit të Phenianit, e bën të papërshtatshëm zhvillimin e takimit të shumëpritur

**UASHINGTON, 24 MAJ** - Shtëpia e Bardhë nëpërmjet një deklaratë njoftoi se është anuluar takimi në mes të presidentit Donald Trump dhe udhëheqësit koreano-verior Kim Jong Un, pas komenteve të sotme nga autoritetet në Phenian, që u shprehën se Koreja e Veriut është e gatshme për të dyja: ballafaqim bërthamor, ose për bisedime në tryezën e negociatave.

Pheniani u shpreh me terma fyese në adresë të nënpresidentit Mike Pence, duke e cilësuar si një "politikan kukull". Në letrën e tij drejtuar udhëheqësit koreano-verior, presidenti Donald Trump shkruan se revoltimi dhe armiqësia e hapur e shfaqur në deklaratat e fundit të Phenianit, e bën të papërshtatshëm zhvil-

limin e takimit të shumëpritur. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha të enjten, në seancën informuese në Senat, se një ndër arsytet për anulimin e takimit ishte edhe heshtja nga pala koreane-veriore ndaj kërkesave të përsëritura të Uashingtonit për hollësi lidhur me përgatitjet për takimin. Anulimi i takimit bëhet ndërkohë që Koreja e Veriut përmbushi të enjten zotimin për të shkatërruar një ndër objektet që përdorej për prova bërthamore, duke kryer shpërthime në Punggye-ri, një rrjet tunelesh nën malin Mantap.

Objekti i provave bërthamore në pjesën e largët verilindore të vendit u shkatërrua nga shpërthimet që zgjatën disa orë dhe që u ndoqën në distancë



nga gazetarë të huaj. Koreja e Veriut e kishte bërë të ditur vendimin për ta shkatërruar objektin para se të bëheshin të njohura planet për takim mes udhëheqësit Kim Jong Unin dhe presidentit Trump. Masa ishte përshëndetur si një gjest i vullnetit të mirë nga Pheniani. Por,

ekspertët thonë se kjo masë nuk ishte hapi i fundit dhe se nevojitej shumë më tepër për t'i përmbushur kushtet që i ka parashtruar administrata Trump Phenianit për çmilitarizim të plotë bërthamor. Përveç gazetarëve të ftuar, Pheniani nuk kishte lejuar

ekspertët të fushës bërthamore t'i ndiqnin shpërthimet të enjten. Njohës të fushës thonë se edhe pas akteve të ndërmarra sot, objekti nuk është plotësisht jashtë përdorimit, po ashtu Koreja e Veriut ka plot male të tjera ku mund të ndërtohen tunele për prova në të ardhmen.

## Qeveria britanike: Tranzicioni përfundon në dhjetor 2020

**LONDËR, 24 MAJ** - Britania do ta përfundojë periudhën e tranzicionit me BE-në pas Brexitit në dhjetor të 2020-s, bëri me dije zëdhënësja e kryeministres së Britanisë së Madhe, Theresa May.

Zëdhënësja May përsëriti qëndrimin e Britanisë se periudha e tranzicionit do të përfundojë në dhjetor 2020, pasi gazeta "Times" njoftoi se May do të propozonte një periudhë të tranzicionit që do t'i mbulonte çështjet e doganave dhe tregtisë, të cilat do të zgjasin nga viti 2012 deri më 2023, për



ta shmangur nevojën për infrastrukturë ose kontroll në kufirin irlandez.

Në Irlandën e Veriut do të jetë kufiri i vetëm britanik me BE-në pas Brexitit. Të dyja

palët kanë njoftuar se janë angazhuar ta mbajnë kufirin me Republikën e Irlandës të hapur, por gjetja e një zgjidhjeje praktike deri tani ka qenë e paarritshme. Kryeministri irlandez Leo Varadkar, i cili ka mbështetur nga shtetet e BE-së, tha se Dublini nuk do të pajtohej me një vendim të kufizuar kohor. "Në vitin 2023 Qeveria irlandeze nuk do të jetë në gjendje të pajtohet me situatën në të cilën duhet të shtyjme një vendim të tillë të rëndësishëm", tha Varadkar.

## Erdogani: Synimi im, Turqia mes vendeve me të ardhura të larta

**ANKARA, 24 MAJ** - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, shpali programin zgjedhor të Partisë qeverisëse për Drejtësi dhe Zhvillim për zgjedhjet e ardhshme të 24 qershorit, duke u zotuar ta kthejë vendin në një komb me të ardhura të larta.

Erdogani shpali programin zgjedhor në Ankara të titulluar "Parlament i fortë, qeveri e fortë, Turqi e fortë". "Qëllimi i ri i Turqisë është të jetë ndër vendet me të ardhura të larta", tha ai.



"Turqia jo vetëm se do të jetë e pavarur në industrinë e mbrojtjes, por do të bëhet një nga vendet kryesore eksportuese", shtoi presidenti turk.

Erdogani theksoi se do ta rrisin shkallën e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore të grave në mbi 40 për qind deri në fund të vitit 2023. Gjithashtu, Erdogan tha se partia e tij do të garantojë një ekonomi të lartë e të qëndrueshme, së bashku me një rritje të pjesëmarrjes së Turqisë në ekonominë botërore në 1,5 për qind.

## Shefi i OKB-së kërkon çarmatosjen e Hezbollahut

**NJU JORK, 24 MAJ** - Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, i bëri thirrje Hezbollahut - aleat i afërt i Iranit - t'i ndërprisë aktivitetet ushtarake në Liban, Siri dhe gjetkë në rajon. "Një Hezbollah me aftësi të konsiderueshme dhe të sofistikuar


ushtarake, jashtë kontrollit të Qeverisë së Libanit, mbetet çështje shqetësuese", tha Guterres në një raport të dërguar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, raportojnë agjencitë AFP dhe AP. Këshilli i Sigurimit do të diskutojë të enjten raportin e Guterresit. Shefi i OKB-së i bëri thirrje lëvizjes

shiite "të mos angazhohet në ndonjë aktivitet ushtarak brenda ose jashtë Libanit", në përputhje me një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila i bën thirrje Hezbollahut të çarmatoset. Guterres tha se përfshirja e Hezbollahut në luftën civile të Sirisë shkel marrëveshjet e Taifit që

i dhanë fund luftës civile të Libanit të viteve 1975-90, si dhe politikën zyrtare të Libanit për neutralitet ndaj çështjeve rajonale. I shpallur grup terrorist nga ShBA-ja, Hezbollahu ka luftuar për vite me radhë në Siri në anën e forcave qeveritare dhe në Irak së bashku me grupet paraushtarake.







BOB DYLAN

**TROKITJE NË PORTËN E PARAJSËS**

Nënë ma largo këtë beXH nga unë  
Nuk do të më duhet kurrë më  
Po bëhet terr, shumë terr për të parë gjësend  
Ndiej sikur po trokas në portën e parajsës.

*Trak, trak, trak trokas te porta në parajsë  
Trak, trak, trak trokas te porta në parajsë  
Trak, trak, trak trokas te porta në parajsë  
Trak, trak, trak trokas te porta në parajsë*

Nënë, varrosi armët e mia  
Me ato nuk mund të gjuaj më  
HiJe e gjatë e zezë po bie  
Ndiej sikur po trokas në portën e parajsës.

**FËRFËLLIMË NË ERË**

Sa rrugë duhet t'i ecë një njeri,  
që të mund të quhet njeri?  
Sa dete duhet t'i fluturojë një pëllumb i bardhë,  
para se të bëjë një sy gjumë në rërë?

Edhe sa shpesh duhet të fluturojnë gjylet e topit  
para se të syrgjynosen përgjithmonë?  
Përgjigjja miku im përhumbet me erën.  
Përgjigjja fërfëllinë në erë.

Sa vite mund të ekzistojë një mal,  
para se ai të lahet në det?  
Sa vite ca njerëz mund të ekzistojnë,  
para se ata të mund të jenë të lirë?

Po, dhe sa shpesh dikush mund ta fshehtë kokën në  
rërë  
dhe të bëjë gjoja sikur nuk sheh asgjë?  
Përgjigjja përhumbet me erën miku im.  
Përgjigjja në erë fërfëllinë.

Sa shpesh duhet të shikojë tutje një njeri  
para se qiellin të mund ta shohë?  
Dhe sa veshë duhet pasur një njeri,  
që vajin e tjetrit të mund ta dëgjojë?

Edhe sa njerëz do të duhet të vriten që ta kuptojmë  
që, megjithatë, shumë njerëz vdekur kanë?

Përgjigjja përhumbet me erën miku im.  
Përgjigjja, fatkeqësisht, në erë përhumbet.

Sa rrugë në këtë botë  
janë të mbushura me lot dhe mjerim?  
Sa njerëz në këtë botë  
janë dete pikëllimi?

Sa nëna tanimë janë vetëm  
dhe presin e presin edhe sot?  
Përgjigjen miku im,  
e di vetëm era vetë,  
vetëm era vetë përgjigjen e di.

Sa male të mëdha parash jepen,  
për bomba, raketa dhe vdekje?  
Sa fjalë të mëdha thonë ca njerëz sot,  
dhe me këto nuk e zbutin rrezikun dot?

Çfarë fatkeqësie duhet ndodhur dhe më,  
që njeriu t'i thërrasë ndërgjegjes së vet?  
Përgjigjen miku im e di vetëm era,  
vetëm era përgjigjen e di.

Sa njerëz edhe sot vazhdojnë të jenë jo të lirë  
e me sa kënaqësi do të donin të ishin të tillë?  
Sa fëmijë në mbrëmje shkojnë të pushojnë,  
dhe nuk mund të flenë nga uria kurrsesi?

Netëve në ëndrra përgjeronen,  
kur do të bëhet më mirë për ne?  
Përgjigjen miku im,  
e di vetëm era vetë,  
vetëm era vetë përgjigjen e di.



FEDERICO GARCÍA LORCA

**KËNGË KALORËSI**

Kordoba.  
Shumë larg dhe e vetmuar.

Mëza të zinj, hënë e madhe  
Dhe ullinjtë në janxhikun tim të shalës.


Edhe pse unë rrugën e di,  
kurrënjehëre në Kordoba nuk do të mbërrij.

Përmes rrethinash, përmes erës  
mëza të zinj, hënë e kuqe.  
Vdekja shikon nga Kullat e Kordobës  
tatëpjetëzës nga unë.

Ah, ç'rrugë e gjatë!  
E ç'kalë i shkathët ah!  
Ah, që vdekja mua po më pret  
Para mbërritjes në Kordoba!

Kordoba,  
larg shumë dhe e vetmuar.

(Shënim: Kordoba. Original: Cordoba)



BERTOLT BRECHT

**PËR NJERËZIT E MËDHENJ**

1.  
Njerëzit e mëdhenj thonë shumë gjëra të çmendura  
Të gjithë njerëzit e tjerë i marrin për budallenj  
Dhe njerëzit nuk thonë asgjë dhe i lënë të bëjnë  
Kështu që koha ikën tutje.

2.  
Njerëzit e mëdhenj hanë por edhe pinë  
Dhe mbushin barkun e tyre  
E njerëzit e vegjël dëgjojnë për bëmat e tyre  
Hanë dhe pinë po ashtu.

3.  
Aleksandrit të Madh  
I duhej Babilonia për të jetuar  
E kishte njerëz të tjerë  
A tyre nuk u duhej asgjë. Një nga ata je edhe ti.

4.  
Koperniku i madh nuk shkonte të flinte  
Ai kishte një dylbi në dorë  
Dhe përllogariste: toka sillet për rreth diellit  
Dhe besonte xhanëm, që ai e kuptonte qiellin.

5.  
I madhi Bert Brecht nuk i kuptonte as gjërat më të  
thjeshta  
Dhe lodhej së menduari për gjërat e vështira si, për  
shembull, për barin  
Dhe e lavdëronte Napoleonin e Madh  
Sepse edhe ai hante.

6.  
Njerëzit e mëdhenj bëjnë gjoja janë dijetarë  
Dhe flasin me zë të lartë - sikur të shurdhrit  
Njerëzit e mëdhenj do të duhej të dekoroheshin  
Mirëpo nuk do të duhej besuar asnjeri.

JOHANNES R. BECHER  
(1891-1958)**EXIL**

Ju që në vendlindjen tuaj ktheheni  
Ju, të mërguarit, që rrugës suaj të gjatë  
Rrugës së pafundme gjer në fund i shkuat  
Dhe keni dëshiruar vetëm një gjë - ditën e kthimit.

Dhe ju, të syrgjynosurit gjithashtu, që plot ankth  
Jeni çapitur dhe në heshtje keni kundërshtuar  
Nga pritja e gjatë lodhur dhe drobitur  
Në mes të popullit tuaj zënë rob.

Jeni të njoftuar dhe e shihni banderolën:  
"Ju që vini, lëreni udhëtimin tuaj plot shpresë të ecë!"  
Nëse mallkim i syrgjynosjes nuk ju njeh juve.

E luani si më parë një lojë të humbur  
Para se ne të ishim të përndjekur nga Gjermania  
Kishte vite që tanimë jetonim në Exil

(Përktheu dhe përshtati nga gjermanishtja:  
Isuf Sherifi)



LULZIM Tafa

**DITË TË KIAMETIT NUK KA**

Dielli n'deti ka me ra  
Zjarrmi ka me shkymë  
Në ujë të valë të detit

Vetëm sytë na i marrin  
Na i qesin në ujë  
Për shnet të Zotit

Mos u tutni bre  
Se ditë kiameti nuk ka  
Kiameti natën ka me u ba.

**LABORATORI**

Qysh  
Po maroni heronj  
Në bodrume

Pa asnji kusht higjienik  
Në atë pisllek  
Ku bahen heronjtë  
Dhe ku  
shiten me atë çmim

**DOVË PËR DASHURINË**

Ti nuk di dovë tjetër  
Përveç asaj të Dashurisë  
Prandaj unë s'e di pse  
Të quajnë ty  
Rrospi

**HANA**

(krejt të duan ty, s'i unë askush)

Së paku punën tane  
ta kisha ditë  
Pas një komunikimi të përhantë  
Çdo natë  
Hanë  
Kthjellët apo vranët



E jashtëzakonshme

## Franca po pushtohet nga krimbat grabitqarë

Biologët në Francë kanë paralajmëruar për një invazion të krimbave gjigantë grabitqarë në territorin e këtij shteti përmes katër kontinenteve. Infektimi nga këta krimba, sipas studiuesve paraqet kërcënim për faunën. Ky lloj i krimbit është me madhësi sa gishtat e dorës.




FOTO E DITES



Anëtarët e Gardës Presidenciale performojnë para varrit të ushtarit të panjohur në Athinë. /AP/

E rrallë

## Sadam Hussein asnjëherë nuk e përdori jahtin luksoz

Jahti luksoz i Sadam Husseinit do të shërbejë si një hotel për marinsat detarë të Irakut që lundrojnë në Basra. Diktatori i Irakut nuk arriti të hipë asnjëherë në jahtin 30 milionë dollarë. Në këtë super jaht gjendet një krevat madhështor me çarçafë mëndafshi, me një tualet të artë dhe karrige berberi.



## BARSOLETA E DITËS



### Babai dhe vajza

- Ç'ndodhi me ty sot, bija ime, vetëm gjysmë ore e mbajte telefonin në dorë.
- Solla një numër gabimisht babi.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjate vikendit në ora 15:00

## “AVENGERS: Infinity War” 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

## “ISLE OF DOGS”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

## “DEADPOOL 2” (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

**Regjia:** David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, “DEADPOOL 2” do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

## “I FEEL PRETTY”

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.

 <p><b>DASHI</b> Sot nuk do të jeni aspak të qetë. Një problem i minutës së fundit do të bëhet i pazgjidhshëm me kalimin e orëve.</p>	 <p><b>DEMI</b> Doni të ikni nga zhurmat dhe rrëmuja e metropolit sot të gjithë ju që jetoni në qytete të mëdha. Do të gjeni mundësi shpëtimi me shoqërinë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Një ditë e qetë dhe mbrëmja do të kalojë këndshëm, mbase në një ambient ku do të kërceni dhe do të argëtoheni.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Një ditë mjaft intensive, me çaste të mira dhe të këqija. E rëndësishme është të qëndroni gjithmonë korrekte me të tjerët.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot po tregoheni diplomat me situatat dhe njerëzit që po ju paraqiten. Nuk do t'i shprehni hapur mendimet tuaja edhe pse jeni të sigurt.</p>	 <p><b>VIRGJËRISHA</b> Disa këshilla të zgjuara të një kolegut tuaj sot do t'ju hyjnë shumë në punë. Do të dini se si ta falënderoni në të ardhmen.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Mos u përbalini me njerëz që mund t'ju bezdisin sot. Lërinë të kalojnë situata të caktura, më pas përgjigjuni me veprime konkrete.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Jeni të lodhur me çështje të ngatërruara që jua ofron dita. Ndjeni nevojën e shoqërisë së njeriut tuaj të dashur që ju kupton më mirë se kushdo.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Disi të shpërqendruar sot, por dita në përgjithësi do të kalojë e qetë. Edhe pse nuk doni ta pranoni, ndjeni diçka për një koleg tuajin.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Sot i keni të gjithë planetët kundër dhe do të jetë një sforcim i madh nga ana mendore të arrini të përbaloni çdo moment të ditës.</p>	 <p><b>UJORI</b> Edhe pse dita do të jetë shumë e ngjeshur, dëshironi ta jetoni dhe ta shijoni çdo moment deri në mbrëmje vonë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Intuitive dhe kreative sot do të jeni epiqendra e ditës për shumë persona. Megjithëse të qetë, energjia që përçoni është pozitive.</p>



## Kim Kardashian në Disneyland me fëmijët



**Y**lli televiziv Kim Kardashian ka ndarë disa çaste të shkëlqyera me fëmijët e saj, North dhe Saint. 37-vjeçarja përzgjodhi Disneylandin në Kaliforni për të kaluar një ditë të bukur.


Ajo ishte e shoqëruar edhe nga motra e saj Kourtney, nipat dhe mbesat. Kimi kishte të veshur rroba nga linja e bashkëshortit të saj, duke përfshirë edhe një xhaketë me ngjyrë të gjelbër.

## Ronaldinho do të martohet me dy femra



**R**onaldinho do të martohet me dy femra njëkohësisht. Sipas medieve braziliane, ish-futbollisti i Barcelonës dhe Milanit aktualisht po bashkëjeton

me dy të fejuarat e tij, Priscilla Coelho dhe Beatriz Souza, në mansionin e tij në Rio de Zhaneiro dhe shumë shpejt do të martohet me të dyja.



## Rihanna shkëlqen në daljet në Londër

**H**erën e fundit që qëndroi në Londër ishte në një vizitë sekrete me të dashurin e saj Hassan Jameel. Kësaj radhe Rihanna u tregoi të gjithëve se po

e shijon Londrën, duke shkëlqyer për vete. Ajo është parë në orët e para të së mërkurës duke dalë nga klubi i natës Mayfair, ku shijoi muzikën me shoqërinë e saj.

## Shawn Mendes publikon këngën e re "Nervous"



**S**hawn Mendes ka publikuar këngën e re e cila është pjesë e albumit të tij të ardhshëm. Këngëtari 19-vjeçar ka publikuar këngën "Nervous".

Ai gjatë fundjavës që lamë pas u paraqit në skenën e Billboard Music Awards 2018 për një paraqitje bashkë me mysafirë të veçantë.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

FALKENBERGS - VARBERGS

1

AVAI - PAYSANDU

1

PAKHTAKOR - BUNYODKOR

GG

# Ferizaj në Superligë

Ferizaj e ka bërë hapin e madh, duke u rikthyer në elitën e futbollit të Kosovës. Skuadra e drejtuar nga Bylbyl Sokoli e mposhti Vëllaznimit pas penalltive, me rezultat 3-2. Në këtë ndeshje u pensionua edhe zyrtarisht mbrojtësi Erdin Hashani



**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 24 MAJ** - Skuadra e Ferizajt e ka siguruar rikthimin në Vala Superligën e Kosovës në futboll, pasi e ka mposhtur Vëllaznimit, pas ekzekutimit të penalltive, me rezultat 3-2. Pas rënies së Vëllaznimit në Ligën e Parë, trajneri Gani Sejdiu ka thënë se ky është çasti më i rëndë në jetën e tij. "Ne e kemi dhënë maksimumin për ta fituar takimin, por pasojat e mëhershme kanë reflektuar. Është çast i vështirë, sepse djemtë kanë dhënë maksimumin për ta fituar ndeshjen. Edhe në ndeshjen e kaluar treguam se kemi probleme në fazën e sulmit, kurse kundërshtari është përgatitur për këtë ndeshje dhe vazhdimisht e ka vonuar lojën për të shkuar në penallti, që është e drejtë e tij", ka thënë Sejdiu, duke shtuar se "puna e penalltive është psikologjike, ani pse portieri ynë na dh dy shanse të mira që nuk i shfrytëzuam. Lojtarët ishin në presion të madh dhe refuzuan të gjuajnë penallti, pran-

daj mua më vjen keq për këtë që ndodhi. Jam munduar ta jap maksimumin në punë. Kohë më të vështirë në jetë nuk kam pasur". Në pjesën e parë të ndeshjes ishte skuadra e Bylbyl Sokolit që pati një iniciativë të lehtë, duke krijuar dy raste shënimi që nuk i konkretizuan në gol Haliti dhe Rexhepi, kurse në fund të pjesës së parë Vëllaznimi e patë një rast të mirë, por Blakçori ishte vendimtar. Në pjesën e dytë Dautaj dhe Mulaku tentuan të shënojnë për Ferizajn, por pa sukses, sikurse që dështoi Rogova për Vëllaznimit. Nëntëdhjetë minutat përfunduan pa gola dhe skuadrat shkuan në vazhdim. Edhe në dy vazhdimet nuk u shënuan gola, kurse fituesi i kësaj sfide u përcaktua në penallti. Portieri i Vëllaznimit i ndali dy gjuajtjet e para të ekzekutuara nga Shabani dhe Hashani, në anën tjetër edhe portieri i Ferizajt, Armend Blakçori, tregoi formë të lartë duke pritur fillimisht gjuajtjen e Bardhokut dhe të Richard Asares, kurse edhe penalltinë vendimtare të

Besnik Krasniqit. Pas ndeshjes Bylbyl Sokoli ka deklaruar: "Vëllaznimi është një ekip më cilësor se Ferizaj, por ne e zgjedhëm një strategji të tillë të lojës për të shkuar në penallti. Kemi arritur t'i neutralizojmë sulmet e kundërshtarit dhe shanset tona i kemi kërkuar në penallti. Fillimi ishte i keq, por kisha besim se edhe Vëllaznimi do të ketë telashe në ekzekutimin e penalltive dhe shpejt u stabilizuar, duke e barazuar rezultatit. Kosova ka nevojë për Vëllaznimit në Superligë, kurse Ferizajt i duhet një riorganizim për Superligë". Inkuadrimit e Ferizajt në elitë e ka përshëndetur edhe kryetari i kësaj komune, Agim Aliu. Ai ka premtuar se skuadra e Ferizajt do të jetë në krye të renditjes tabelore edhe në Superligë. "Urime hyrja e KF 'Ferizaj' në Superligë! Urime tifozëve 'Ujqit'! Futbollit ferizajas po këndellet. Bashkë do ta rendisim aty ku e ka vendin, në majat e renditjes tabelore", ka shkruar Aliu në llogarinë e vet në "Facebook".

## SHKURT

### Ajeti: Nuk kam marrë kurrë kërkesë zyrtare nga Shqipëria

Albian Ajeti ka trazuar ambientin kuqezi me një deklaratë. Ai prej muajsh shihej si tradhtar nga tifozët shqiptarë, pasi zgjodhi ta përfaqësonte Zvicrën në vend të ngjyreve kuqezi. Vëllai i tij, Arlind Ajeti, është pjesë e kombëtares shqiptare dhe ky është një rast i veçantë. Kur është pyetur nga mediet zvicerane se a është kontaktuar ndonjëherë nga Shqipëria, Albani është përgjigjur: "Asnjëherë në mënyrë direkte. Ata kanë pyetur Arlindin për gjendjen time, por jo për gjëra të rëndësishme. Kjo për mua nuk llogaritet", ka deklaruar Ajeti.

### Shqipëria mposhti Kosovën

U zhvillua në "Elbasan Arena" miqësorja e parë për 19-vjeçarët në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Djemtë e trajnerit Erjon Bogdani arritën të triumfonin me rezultatit 2-1 falë dyshes së Pashës në minutën e 21-të dhe 81. Për Kosovën realizoi numri 10, Limani, nga penalltia. Kjo ishte miqësorja e parë midis këtyre dy përfaqësuesëve, pasi më datën 26 mars në "Loro Boriçi" është përcaktuar të luhet dueli i dytë mes Shqipërisë dhe Kosovës, ku të dy trajnerët do t'i provojnë të gjithë lojtarët e grumbulluar.

### Tetë skuadra shqiptare në garat evropiane

Si kurrë më parë, numri i skuadrave shqiptare që do të marrin pjesë në Evropë do të jetë tetë. Në rast se Skënderbeu fiton betejën në KAS do të marrë pjesë në eliminatorët e Ligës së Kampionëve, në të kundërtën stafeta i kalon Kukësit dhe Partizani përfiton duke siguruar Evropën. Luftëtari dhe Laçi janë dy skuadrat e tjera shqiptare që kanë siguruar Evropën. Pra, sido që të ndodhë, Shqipëria do të përcaktohet nga katër skuadra. Për sa i përket Superligës së Kosovës, dy do të jenë skuadrat që do të shkojnë në Evropë. Bëhet fjalë për kampionët e Dritës dhe nënkampionët e Prishtinës. Drita do ta fillojë rrugën drejt Ligës së Kampionëve në fazën paraeliminatore, sepse Kosova është e fundit në renditjen e federatave sipas koeficientit të UEFA-s. Nuk mund të mungojë as përfaqësimi i skuadrave shqiptare në Maqedoni. Si kurrë më parë, dy ekipe shqiptare do të marrin pjesë në kupat e Evropës. Bëhet fjalë për kampionët e Shkëndijës dhe për skuadrën tjetër shqiptare, atë të Shkupit. Pra, në total, do të jenë tetë skuadra shqiptare në Evropë.

## Fadil Vokrri dhe Dua Lipa në finalen Liverpool - Real

**PRISHTINË, 24 MAJ** - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrri, do të jetë i pranishëm të shtunën në Stadiumin Olimpik në Kiev për ta përcjellë ndeshjen finale të Ligës së Kampionëve në mes të Liverpoolit dhe Real Madridit. Në programin festiv

do të jetë edhe këngëtarja shqiptare Dua Lipa. "Me këtë rast, presidenti Vokrri do të ketë edhe takime të shumta me homologët e tij, si dhe me drejtuesit e UEFA-s. Prandaj kjo ngjarje bëhet edhe më e veçantë dhe kjo finale do të jetë më madhështore për faktin se në

tribuna të stadiumit do të kemi një legjendë të futbollit, ndërsa këngëtarja e Kosovës, Dua Lipa, do të paraqitet në programin artistik para ndeshjes finale me hitet e saj dhe kësaj do të paraqitet para miliarda njerëzve anembanë globit", thuhet në njoftimin e FFK-së.





## 5 000 fëmijë të vitit të pavarësisë vrapojnë nesër për Ditën Olimpikë

PRISHTINË, 24 MAJ - Rreth 5 000 fëmijë të lindur në vitin e pavarësisë së Kosovës (2008) do ta shënojnë sot (e premte) Ditën Olimpikë 2018. Komiteti Olimpik i Kosovës këtë herë do të organizohet në shtatë

qendrat e Kosovës: Prishtinë, Gjilan, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë dhe Ferizaj, ku fëmijët do të vrapojnë nëpër sheshet e këtyre komunave. Aktiviteti kryesor mbahet në Prishtinë, ku marrin pjesë

rreth 2 500 fëmijë. Ata do të vrapojnë nga Sheshi "Zahir Pajaziti" deri tek Teatri, derisa do të zhvillohen edhe aktivitete të tjera të pentatlonit modern. Dita Olimpikë 2018

organizohet në bashkëpunim me drejtoritë për arsim të komunave përkatëse dhe fillon në të njëjtën kohë, në orën 09:00. Ky është edicioni i shtatë që shënon këtë ditë.



## Iniesta, kontratë trevjeçare me Vissel Koben



TOKIO, 24 MAJ - Andres Iniesta ka nisur zyrtarisht një jetë të re në Japoni. Ish-kapiteni i Barcelonës ka firmosur një kontratë trevjeçare me Vissel Koben, një klub që prej vitit 2014 zotërohet nga Hiroshi Mikitani, president i grupit "Rakuten", që njëkohësisht është edhe sponsori kryesor i ekipit blaugrana. Në Japoni dhe te Visseli, Iniesta do të gjejë edhe një njohje të

vjetër, jo si koleg, por si rival: Lukas Podolskin. Prezantimin përpara tifozëve të tij të rinj do ta bëjë të shtunën në stadiumin "Misaki Park", e do ta mbajë veshur fanellën me numrin 8. "Japonia është një vend i madh. Më pëlqen gjithçka nga ky ishull. Gjëja më e rëndësishme është fakti se duhet të përshatam me kulturën japoneze. Kam shumë respekt për fut-

bollin japonez. Kam parë Kombëtaren tuaj teksa luan dhe është me të vërtetë në një nivel të lartë. Shpresoj të kontribuoj me stilin tim dhe ta ndihmoj skuadrën të re. Mezi pres të luaj sërish", ka thënë Iniesta. "Andres është një prej lojtarëve më të respektueshëm dhe me siguri se do të ketë një ndikim të madh mes nesh", ka deklaruar shefi i klubit, Mikitani.

## Bostoni një fitore larg titullit

BOSTON, 24 MAJ - Boston Celticsi e ka mposhtur me rezultat 96-83 Cleveland Cavaliersin në finalen e pestë të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, duke udhëhequr 3-2 me ndeshje. Duket se faktori fushë është vendimtar në këtë fazë finale në Lindje, pasi ekipet i kanë fituar të gjitha ndeshjet e luajtura para publikut të tyre. Ndeshja është dominuar nga basketbollistët e Celticsit, që patën epërsi gjatë gjithë kohës, duke u shkëputur deri në 25 pikë në çerekun e fundit, por në fund e ulën ritmin, duke e kontrolluar lojën. Tatum me 24 pikë ishte shënuesi më i mirë për vendësit, ndërkohë që vetëm shtatë lojtarë luajtën për Bostonin në këtë takim. Për Clevelandin u dallua LeBron James, me 26 pikë e 10 rebounde, por pjesa tjetër e skuadrës nuk dha atë që pritej në fushë, e pasaktë në



guajtje. Ndeshja e gjashtë do të luhet në fushën e Clevelandit,

por Bostoni është një fitore larg titullit në Lindje.

### SHKURT

#### Salahi nuk do ta prishë agjërimit për finalen e Ligës së Kampionëve

Ylli i Liverpoolit, Mohamed Salah, do të jetë me agjërimit kur ta luajë finalen e madhe të Ligës së Kampionëve kundër Realit. Sulmuesi egjiptian po agjërton që nga data 16 maj, edhe pse sportistët profesionistë lejohet të mos agjërjnë. Salah, sipas "Al Masry al Youm", u ka thënë të afërmeve që nuk do ta prishë agjërimit, pasi kjo gjë nuk do ta pengojë për të dhënë më të mirën në fushë. Madje Nabil El Zhar, futbollist mysliman që luan me Leganesin në Spanjë, thotë se kur agjërton luan më mirë sepse, sipas tij, është "më i pastër brenda".

#### Costa rrezikon pjesëmarrjen në Kupën e Botës

Dani Aves nuk do të luajë në Kupën e Botës "Rusi 2018" pasi ka pësuar lëndim në skuadrën e PSG-së. Ky mund të mos jetë mungesa e vetme e madhe për Brazilin, pasi edhe ylli i Juventusit, Douglas Costa, rrezikon të mungojë. Costës i është shfaqur një problem muskolor, megjithatë ka shpresë se do ta kalojë këtë dëmtim në kohë, pasi mungojnë edhe rreth 25 ditë nga fillimi i ngjarjes më të madhe të futbollit kombëtare.

#### Hamsik, afër largimit nga Napoli

Marek Hamsik pritet të largohet nga skuadra e Napolit. Mediet italiane raportojnë se lojtari i cili ishte pjesë e Napolit nga viti 2007 mund të transferohet jashtë Italisë. "Mbase vjen një moment, kur rrugët tona duhet të ndahen. Do të kisha shumë dëshirë të provoja diçka të re", ka thënë Hamsik për gazetën sllovaqe "Pravda".

#### Matthaus, Bayernit: Shiteni Thiagon

Legjenda e Bayern Munchenit, Lothar Matthaus, e ka kritikuar mesfushorin spanjoll Thiago Alcantara për formën dhe performancat e këtij viti. Ai beson se klubi "bavarez" duhet ta shesë atë, në rast se merr ndonjë ofertë të mirë. Bayerni humbi 3-1 në finale të Kupës së Gjermanisë kundër Eintracht Frankfurtit gjatë së cilës Thiago u zemërua sepse ishte zëvendësuar. "Thiago ka dështuar ta bëjë dalimin në ndeshje të mëdha. Në fakt, mendoj se ai është i mirë por, kohët e fundit, ka qenë hije e lojtarit që dikur ishte. Thiago më ka zhgënjyer në javët e fundit. Nuk e di se ku e ka mendjen. Me këto paraqitje ai nuk është lojtar për Bayern Munchen. Nëse ndonjë ofertë e vlefshme vjen, atëherë Bayerni duhet ta mendojë atë", ka thënë Matthausi.

#### City, 69 milionë për Mahrezin

Kampionia e Premierë Ligës, Manchester City, është e interesuar që gjatë verës të përforcohet me lojtarë cilësorë. Mediet britanike kanë raportuar se trajneri Pep Guardiola e dëshiron në sezonin e ri, Riyad Mahrezin e Leicester Cityt. Besohet se City do të ofrojë 69 milionë euro për ta bindur skuadrën e Leicesterit që të heqë dorë nga yllin e saj.

#### Valencia e blen përfundimisht Kondogbian

Valencia ka konfirmuar zyrtarisht se ata kanë ushtruar mundësinë e tyre për të nënshkruar me Geoffrey Kondogbia nga Interi. Francezi iu bashkua me klubin Los Che në verën e 2017-s, ndërsa në drejtim të kundërt shkoi Joao Cancelo. Marrëveshja mes dy skuadrave kishte një mundësi blerje përfundimtare para 31 majit për të dy futbollistët, ku Kondogbia do të kushtonte 25 milionë euro, ndërsa Cancelo 35 milionë. "Valencia ka ushtruar këtë të enjte të drejtën e klauzolës së tyre të blerjes në marrëveshjen e huazimit të Geoffrey Kondogbia nga Interi. Francezi ka vënë lapsin mbi letër në një kontratë me klubin që shtrihet deri në vitin 2022. Klauzola e lirim të Kondogbias do të jetë 80 milionë euro. 24-vjeçari ishte një pjesë e rëndësishme e mesfushës së Marcelinos në sezonin e tij të parë në Mestalla, duke bërë 31 paraqitje në ligë dhe duke shënuar katër gola", thuhet në njoftimin e Valencias.





<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>						PIKA KUR TOKA GJENDET MË SË AFËRMI DIELLIT	PJESA MË E LARTË E MË E PRIVILEGJUAR E KLASAVE	PËRFAQËSI DIPLOMATIKE E PËRHERSHME (sh.shq. - vjet.)	I PËRZIER; I TRAZUAR	PJESA E ERRËT E DITËS	<b>EPOKA E RE</b>	RADIATOR PËR NGROHJE	MBAJTJE E ANËS (sh.pashq.)	DESPOTËT	BABAI	RAMADAN AVDIU
BIMË BARISHTORE SHUMË E HIDHUR											SHTET NË AZI (pashq.)					
SHKRIMTARJA KADARE											ISH KËNGËTARJA ..... BITRI					
SHI I IMËT (sh.shq.)											MUNGESË E SHTYPJES, E VARËSISË DHE E KUFIZIMEVE					PJESË E KOMPJUTERIT
VENDLINDJA E ODISEUT											OPEN MOBILE ALLIANCE SMALT				BASHKËT. ISMET MUNISHI	
FATKEQËSI E MADHE; KOB										LUMË NË KOSOVË ZANORE						
ZANORE							GRIMCA MOLEKULARE FORMË QEVERISJEJE NGA NJË GR-UP PASANI-KËSH (shq.)					NËNA THIRRJA QË I BËHET MASËS				
LLOJ LOJE FATI										KOHË BRENDA SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË PUNË VENDEË					BASHKËT. LUMË NË SHQIPËRI	
<b>EPOKA E RE</b>	ISH TRAJNERI I MANCHESTER UNITED NË FOTO	VIOLINISTJA SHQIPTARE .... GEGA	MBARËSIA	SHTET (FR.)	KËMBADORAS	IRMA LIBOHOVA NUMËR THEMELOR (f.)		LLOJ PIJE ALKOOLIKE SHTET EVROPË						SELEN CEREMONI KUR VARROSET DIKUSH		
E METË, MUNGESË; CEN											ARBITËR FUTBOLLI SHTET FEDERAL NË SHBA					
FILM I REGJISORIT JAMES CAMERON												KUNDREJT MJERË MARC ANTHONY				DUKURI E RE
BOKSIERI I FAMSHËM KLITSCHKO									MËSIM PRAKTIK OSE TEORIK IDRIZ ZAJMI							
I VURA NË SITË						AKTORI YNË ... ISLAMI (shq.) ANTIGONA SEJDIU				VEND I CEKËT NË NJË LUMË VARR I NJË SHENJTORI MYSLIMAN				KËNGËTARJA ... KOÇI PËRSËRITËS (gram.)		
BASHKËT.		PJESË E ILIRISË	ZENEL OSMANI	IRONI THERËSE DHE E HIDHUR (shq.) HAJDE								REGJISORJA SHQIPTARE .... ELEZI KAMPIONI, ASI (Sport)				
USHQIM QË SHTROHET E HAHEM GJATË PIJES					TRAJNERI ANGLEZ .... BRUS (shqip.) KËNGËTARJA ..... MIMANI				KËNGËTARJA SOPJANI						ZANORE KËNGËTARJA ..... BERISHA	
KRAHINË NË KOSOVË						"I" pas dy "A" AFËRDITA DRESHAJ			KËSULË BURRASH (shq.) MANIA, HUQI							ISH ATLETJA MERLIN
JEMENI, INDONESIA			ISH SEKRETARI I OKB-së KOFI .... PARAPAGIM					ISH AKTORJA GARDNER LËVIZJA POPULLORE				ANNA RUSO I DHËNË FALAS			DRITA OSAJ VOZË E MADHE DRURI (shq.)	
EPOKË (shq.)				JETË E QETË AKTORJA SHQIPTARE .... XHENETI (shq.)					PRINCIPATË ARABE (sh.shq.) PASURIA E PËTUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA							
KËNGËTARJA TURKE ..... XHAN					DY BASHKËTINGËLLORE	I PISTË EASTERN UNIVERSITY GAMES				RRIPI I LLAMBËS MODELJA AMERIKANE .... UPTON (origj.)						
<b>EPOKA E RE</b>	HARK, KTHESË	VEZAKE GYP NËPËR TË CILËT KALON GJAKU (shq.)						ZOG ROSE, BIBË ROSE (shq.) POSEDOJ DIÇKA					INTENSITET, NIKEL ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. origj.)			PËREMËR PRONOR
ROKERI I FAMSHËM .... KRAVITZ (shqip.)					TITULL I LARTË ARISTOKRATËSH (shq.) KYÇ				TË FIKËT INDIUM							
AKTORJA ..... ISMAILI						BËRË GATI ZANORE							KORNIZË LIVORNO			
FURRA KU PIQEN TJEGULLA							LËNDË QË GJENDET E NGURTË NË KOREN E TOKËS (shq.)								ZANORE	





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica So

Kryetari i Komunës

Nr. 01-111/01-0028364-3/18 dt. 25.05.2018

Mitrovicë

Në bazë të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 22 paragrafi 3 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, Komuna e Mitrovicës së Jugut shpallë:

#### NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË SHPALLJES SË REKRUTIMIT

